

VENDIM
Nr. 508, datë 30.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 248, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) targat e mjeteve rrugore të përkohshme: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të kuq, shenja dalluese PRK (përkohshme). Figurat III.4/1.c, III.4/2.c, III.3/c, III.4/1.c1, III.4/2.c1 dhe III.3/c1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

2. Në shkronjat “dh” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 245, të shtojcës X, bashkëlidhur rregullores, fjalët “... një karakter numerik ...” zëvendësohen me “... deri në dy karaktere numerike ...”.

3. Pas figurës III.3/c, të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur rregullores, shtohen figurat III.4/1.c1, III.4/2.c1 dhe III.3/c1, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA

Figura III.4/1.c1, neni 248




Figura III.4/2.c1, neni 248



Figura III.3/c1, neni 248

